# DËSHMI ARKIVI

**A-478340**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | TOP BAROMETER: PS-ja zbret në dyshemenë e saj elektorale, por… |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/blogu-tema/top-barometer-ps-ja-zbret-ne-dyshemene-e-saj-elektorale-por-i589106` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 29 shtator 2026, 08:32:39 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 29 shtator 2026, 08:27:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `ed34fc21c23f6eb24fb0b7fd9d342b416198aacb1e1fc4be378352d4bb5dabd9` |
| TEKSTI | `539c28a511f28d2518ced4fd1ef6b073f67423edae3fc93fc9e771c309554b1d` |
| PAMJA | `e9210f0f06fca9afcf1145d44af7085988c1dbb1a66867deace69d0bb214f798` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `fa9e584d6c16be8c059b74dcfe5c22a88dcc6f912fdcecabd3cbd2fb80ead9fc` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/fa9e584d6c16be8c059b74dcfe5c22a88dcc6f912fdcecabd3cbd2fb80ead9fc`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# TOP BAROMETER: PS-ja zbret në dyshemenë e saj elektorale, por…

TemA

29 Shtator 2026, 10:27Blog TEMA

**Nga Eduard Zaloshnja**

Dje zhvillova sondazhin elektronik TOP BAROMETER për emisionin Top Story, përmes shpërndarjes së linkut të pyetësorit me SMS krejt të rastësishme nga Vermoshi në Konispol. Pyetësorin e plotësuan 1411 banorë të rritur të vendit.

Nga sondazhi rezultoi se vetëm 60% e popullsisë së rritur të vendit do të votonte sot, nëse zhvillohen zgjedhje parlamentare (shihni grafikun 5).

Grafiku 5




**Po ata që votuan vjet brenda vendit, si do të votonin sot?**

Rreth 42.4% do të votonin sot për PS-në, nga 52.2% që votuan vjet për të. Rreth 23.9% do të votonin sot për PD-ASHM-në, nga 34.3% që votuan vjet për të. Dhe rreth 11.6% do të votonin sot për partitë e vogla që garuan vjet (10 gjithsej), nga 13.5% që votuan vjet për to (shihni grafikun 6).

Nga gjithë sondazhet që kam zhvilluar pas zgjedhjeve të vjetshme, më rezulton se PS-ja ka zbritur aktualisht në dyshemenë e saj elektorale. Në një situatë të ngjashme ka qenë vetëm pasi SPAK-u kërkoi pezullimin e Belinda Ballukut nga postet e saj në qeveri. Sidoqoftë, sot PS-ja ka pothuaj dyfishin e votave të PD-ASHM-së, ndërkohë që partitë e vogla janë shumë poshtë saj.

Grafiku 6




Meqë kampioni i sondazhit përfaqëson me përafërsi statistikore të gjithë popullsinë e rritur të vendit, mund të ekstrapolohet statistikisht se rreth 760 mijë banorë të rritur nuk do të votonin sot për asnjë nga partitë ekzistuese (40% e 1.9 milionëve).

**Po si votuan vjet ata që nuk do të votonin sot?**

Rreth 57.5% nuk votuan fare vjet; pothuaj 20% votuan vjet për PD-ASHM-në; pothuaj 19% votuan për PS-në; dhe rreth 3.7% votuan për partitë e vogla (shihni grafikun 7).

Grafiku 7



[Kryengritja e Pallatit të Drejtësisë konfirmon dëshirën për të drejtuar “Republikën”]

20:36 Blog / 22 komente

[A e ekspozoi SPAK së tepërmi SHISH-in?]

17:20 Blog / 12 komente



[Viti i kalit, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së dhe 193 fjalime]

15:10 Blog / 2 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.